



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/97

Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, nenit 21 të Rregullores Nr. 23/2012 për Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet Sekretaria e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të Dëshmorit të kombit, Invalidit, Veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Sekretaria).
2. Sekretaria mbështet Komisionin në të gjitha punët administrative duke përfshirë:
  - 2.1. Pranimin e të gjithë dokumentacionit që posedojnë shoqatat e dala nga lufta dhe Zyrat përkatëse të Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale;
  - 2.2. Pranimin dhe bartjen e të gjithë dokumentacionit të Ish TMK-së i cili ka të bëjë me listat e Ushtarëve të UÇK-së dhe të mbajë në dispozicion të Komisionit;
  - 2.3. Mbështetjen teknike në përpilimin e regjistrave të aplikuesve sipas kategorive;
  - 2.4. Menaxhimin e e-mail adresës së komisionit;
  - 2.5. Menaxhimin me procedurat e ankimit;
  - 2.6. Mbajtjen e procesverbalit të takimeve;
  - 2.7. Njoftimin e anëtarëve të Komisionit për rendin e ditës, kohën dhe vendin e takimit;
  - 2.8. Përgatitjen projekt buxhetit për shpenzime gjatë punës së komisionit.
  - 2.9. Kryerjen e të gjitha punëve tjera sipas kërkesës së Kryetarit të Komisionit për mbarëvajtjen e punës.

3. Sekretaria udhëhiqet nga drejtori i Zyrës për Çështje të Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në pajtim me nenin 17 (2.4) të Ligjit Nr. 04/L-054 .
4. Personeli i Sekretarisë përbëhet nga këto pozita:
  - 4.1. Udhëheqësi i Sekretarisë-Drejtori i ZVL-UÇK-së;
  - 4.2. Zyrtar administrativ me nivel të pagës 500 (pesëqind) euro bruto në muaj;
  - 4.3. Tre (3) Punëtor Administrativ me nivel të pagës 400 (katërqind) euro bruto në muaj.
5. Angazhimi i këtyre pozitave bëhet me kontratë mbi vepër për një periudhë të caktuar sipas mandatit të Komisionit, dhe përzgjidhen nga ZVL-UÇK në bashkëpunim me Kryetarin e Komisionit Qeveritar.
6. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së siguron hapësirën për Sekretari, me të gjitha pajisjet për punë, duke përfshirë materialin shpenzues dhe një makinë.
7. Ndahen mjete Financiare në vlerë prej 7,000.00 (shtatë mijë) euro për nevojat e Sekretarisë nga pika 1. e këtij vendimi.
8. Mjetet nga pika 7. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Zyrën për Veteranët e Luftës/Zyrën e Kryeministrit.
9. Buxheti tjetër i nevojshëm për punën e Komisionit me këtë vendim të Qeverisë bartet në ZKM-ZVL;
10. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë